



S T A T U T I

I FEDERATËS SPORTIVE TË PUNËTORËVE TË KOSOVËS

**Prishtinë,
Janar, 2018**

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

Komiteti Ekzekutiv (KE) i Federatës Sportive të Punëtorëve të Kosovës, në mbledhjen e vet të rregullt, të mbajtur më 28/09/ 2016, miratoi këto ndryshime dhe plotësime të Statutit, dhe i propozon Kuvendit për miratim të këtyre ndryshime dhe plotësimeve të këtij:

STATUTI

1. EMËRTIMI, FORMA, dhe ADRESA

- 1.1. Kjo organizatë do të quhet Federata Sportive e Punëtorëve të Kosovës.
- 1.2. Ajo mund të quhet edhe si FSPK.
- 1.3. Federata në esencë është shoqatë jo-fitimprurëse, në harmoni me nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr.03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- 1.4. Federata nuk do të bëjë shpërndarjen e fitimit neto në individ. Pasurinë, të ardhurat dhe profitin e vet do t'a përdor për të realizuar qëllimet jo-fitimprurëse të vet Federatës. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i Federatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jo-fitimprurëse të vet Federatës, dhe në asnjë formë nuk do të përdoren për të krijuar benefite të vecanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, anëtarë të shoqatës apo donatorë të OJQ-së.

Kjo nuk don të thotë se nuk mund të bëhen pagesa për kompensim të arsyeshëm, me vendim të Komiteti Ekzekutiv, për ata persona që bëjnë punë me interes për Federatën.
- 1.5. Transaksionet eventuale në mes të anëtarëve, anëtarëve të Komiteti Ekzekutiv, personit ose nëpunësit të vet Federatës, duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për Federatën.
- 1.6. Federata, zyrën e vet qendrore e ka në Prishtinë, Kodra e Diellit, Zona e Lindjes, Lam.1,nr.1

2. THEMELUESIT

- 2.1. Themeluesit e Federatës janë:
 - PTK, Dardania p.n., përfaqësues: Ismail Sadiku, K.Diellit, Z.Lindje, Lam.1, nr.1
 - TEB, Shpend Maxhera;
 - Dogana e Kosovës, Naim Gerbeshi;
 - Hekurudhat e Kosovës, Sefedin Sefaj;
 - Kompania Ipko, Basfort Jaha; dhe
 - Kujtesa net, Kujtim Sopi;
- 2.2. Përfaqësuesi i autorizuar i Federatës, në Kosovë është Ismail Sadiku, Kodra e Diellit, Zona e Lindjes, Lamela 1, nr.1, Prishtinë.
- 2.3. Përfaqësuesi i Federatës emërohet nga Kuvendi i anëtarëve dhe ka për obligim t'a përfaqësoj Federatën në Kosovë dhe të pranoj të gjitha shkresat zyrtare në emër të Federatës. Ai/ajo duhet të jetë personi përgjegjes për informim të autoriteteve relevante administrative për të gjitha ndryshimet që mund të ndodhin në Federatë.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

3. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

3.1. Qëllimet themelore të FSPK janë:

- Masovizimi i sportit tek punëtorët e institucioneve dhe kompanive të ndryshme me qëllim të promovimit të frymës sportive në garat që organizon Federata;
- Ndihma e anëtarëve për realizim të qëllimeve për të cilat janë anëtarësuar në FSPK;
- Promovimin e aktiviteteve lidhur me realizimin e praktikave më të mira sportive për të dy gjinitë, duke pasur parasysh moshëm dhe mundësitë e tyre fizike, me qëllimin kryesor të mbrojtjes dhe ngritjes së shëndetit të tyre;
- Përdorimi i sportit dhe mjeteve tjera për promovim të paqës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në mes punëtorëve dhe formave të tyre organizative;
- Mbështetja për promovim dhe zhvillim të sportit edhe në ato institucione, kompani ku një gjë e tillë është në nivel jo të kënaqshëm;
- Ndertimi dhe kultivimi i marrëdhënjëve të shëndosha brenda anëtarësisë, që nënkupton miqësinë, solidaritetin, tolerancën, mosdiskriminimin, transparencën, ndershmërinë;
- Bashkëpunimi me organizata të ngjashme në regjion dhe më gjërë.

3.2. Aktiviteti i Federatës bazohet në organizimin dhe mbajtjen e garave në disiplinat e ndryshme sportive, siç mund të janë: futboli i vogël, basketbolli, volejboli, ping-pongu, shahu etj.

4. ANËTARËT, ANËTARËSIMI, KUOTA PËR ANËTARËSIM DHE HUMBJA E TË DREJTËS SË ANËTARËSISË

4.1. ANËTARËT DHE ANËTARËSIMI –Anëtarësimi në Federatë është i hapur për çdo person, pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike. Anëtarë të Federatës trajtohen të gjithë ata që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë dhe që janë të regjistruara pranë organeve kompetente të Republikës së Kosovës.

4.1.2. Anëtarësimi bëhet me aktin e nënshkrimit të deklaratës për anëtarësim në Federatë.

4.1.3. FSPK ka të njohura këto kategori të anëtarësisë:

- Anëtarët aplikant;
- Anëtarët kandidat; dhe
- Anëtarët e rregullt.

Anëtarët aplikant janë të gjithë ata që aplikojnë për anëtarësim në FSPK.

Anëtarët kandidat janë të gjithë ata që kanë aplikuar për anëtarësim, dhe nga FSPK-ja marrin përgjegje pozitive për anëtarësim në Federatë, por që akoma nuk kanë nënshkruar deklaratën për anëtarësim në FSPK-ës.

Anëtarë të rregullt të FSPK, trajtohen të gjithë ata që kanë aplikuar dhe kërkesat e të cilave janë miratuar nga Komiteti Ekzekutiv dhe kanë nënshkruar deklaratën për anëtarësim në FSPK.

4.1.4. Pranimin e anëtarëve në Federatë e bënë Komiteti Ekzekutiv i FSPK-ës, në harmoni me vendim të Kuvendit.

4.1.5. Përmbajtjen e deklaratës për anëtarësim e përpilon dhe miraton Komiteti Ekzekutiv i FSPK-së.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

- 4.2. KUOTA PËR ANËTARËSIM** – Caktimi i lartësisë së kuotës për anëtarësim është e drejtë e Komiteti Ekzekutiv të Federatës, e përcaktuar me vendim të Kuvendit.
- 4.3. HUMBJA E TË DREJTAVE TË ANËTARËSISË** - Anëtarë që nuk i respekton rregulloret e FSPK-së apo që nuk paguan kuotën e anëtarësimit brenda afatit të përcaktuar me aktet normative të FSPK-së, automatikisht e humb të drejtën e anëtarit në FSPK.
- 4.3.1.** Kur anëtarë nuk ka paguar anëtarësinë me kohë, por me shkrim i është drejtuar Komiteti Ekzekutiv të FSPK me të cilën obligohet që brenda një periudhe të caktuar kohore do të paguaj obligimet, Komiteti Ekzekutiv mund të marrë vendim që ai do të trajtohet edhe mëtutje anëtarë, por nuk do të ketë të drejtën e votës në mbledhjet e organeve të FSPK-së, për derisa të bëjnë pagesën e plotë të obligimit. Pagesa e plotë e obligimeve, dhe në harmoni me vendim paraprak të Komiteti Ekzekutiv, nënkupton revokim automatik të drejtave të përcaktuara me këtë Statut.
- 4.3.2.** Suspendimi nga FSPK-së ndodh edhe në rast të mosrespektimit të Statutit të FSPK-së. Kohëzgjatja e suspendimit duhet të përcaktohet. Suspendimi do të revokohet nga Kuvendi i FSPK-së, atëherë kur anëtarë i suspenduar, me shkrim njofton se rregullat e shtruar nga FSPK-ja do t'i respekton dhe zbaton.

5. ORGANET E FEDERATËS

Organet e Federatës janë:

- Kuvendi;
- Kryetari;
- Komiteti Ekzekutiv; dhe
- Këshilli Mbikqyrës.

5.1. KUVENDI

- 5.1.1.** Kuvendi është organi më i lartë i Federatës. Ai përbëhet nga gjithë anëtarët e Federatës;
- 5.1.2.** Me punën e Kuvendit udhëheq Kryesia e ngushtë Federatës, përkatësisht Kryetari dhe dy nënkryetarët e Federatës;
- 5.1.3.** Mbledhjet e Kuvendit janë të rregullta dhe të jashtëzakonshme;
- 5.1.4.** Kuvendi do të mbaj mbledhje të rregullta së paku dy herë në vit. Ftesa për Kuvend të rregullt, duhet t'u dërgohet anëtarëve të Kuvendit së paku 15 ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes, ndërsa materiali duhet t'u dërgohet së paku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes;
- 5.1.5.** Kuvendi përbëhet nga përfaqësues të anëtarëve të Federatës. Anëtarë të Kuvendit janë edhe Kryetari i Federatës (me të drejtë vote), dhe Kryesuesi i Këshillit Mbikqyrës (pa të drejtë vote);
- 5.1.6.** Përfaqësues në Kuvend mund të bëhen personat që plotësojnë këto kushte elementare:
- Janë të punësuar, që nënkupton se janë të moshës madhore, mbi 18 vjet;
 - Janë të deleguar nga institucioni, kompania pëkatëse; dhe
 - Janë shtetas të Republikës së Kosovës.
- 5.1.7.** Vetëm anëtarët e rregullt kanë të drejtën e votës. Një anëtar paraqet një votë. Në rast të numrit të njëjtë të votave **për** ose **kundër**, vendos vota e kryesutit të mbledhjes së Kuvendit.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

5.1.8. Numri i përfaqësuesve të institucioneve dhe kompanive të ndryshme, do të jetë i barabartë. Të gjithë do të përfaqsohen me nga 2 (dy) delegat në Kuvend.

Gjinisë femërore duhet kushtuar kujdes i veçantë në procesin e zgjedhjes në organe.

5.1.9. Nëse përfaqësuesi i institucionit/kompanisë e ndërpreu marrëdhënjen e punës me kompaninë që e ka deleguar si përfaqësues ose garues të vetin, automatikisht e humb të drejtën e përfaqësimit apo të garimit për atë institucion/kompani dhe duhet të plotësohet me anëtarë të rinjë.

5.1.10. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit e thërret dhe me të kryeson Kryetari i Federatës;

5.1.11. Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mund ta thërret Kryetari i Federatës, 1/3 e anëtarëve të Kuvendit ose edhe Këshilli Mbikqyrës i Federatës;

5.1.12. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit mbahet nëse në të marrin pjesë 50%+1 e anëtarëve, kurse vendimet në Kuvend mund të mirren nëse votojnë 2/3 e anëtarëve të pranishëm;

5.1.13. Mbledhjen e Kuvendit e udhëheq Kryetari i Federatës;

5.1.14. Mënyra e punës së Kuvendit, rregullohet me rregulloren e punës së Kuvendit;

5.1.15. Kuvendi, me propozim të Komiteti Ekzekutiv, mund të revokon anëtarin e Komiteti Ekzekutiv para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, nëse ai nuk e ushtron detyrën e tij në harmoni me dispozitat e këtij Statuti dhe me vendimet e Komiteti Ekzekutiv dhe të Kuvendit;

5.1.16. Kuvendi ka të drejtë të revokon edhe Komitetin Ekzekutiv në tërësi, kur në punën e tij vëren: neglizhencë, njohuri të pamjaftueshme për kryerje të detyrave të përcaktuara nga Kuvendi, pengon punën dhe veprimtarinë e Kuvendit përkatësisht pamundëson ose pengon zbatimin e politikës zhvillimore të Federatës;

5.1.17. Veprimtaria e Kuvendit fokusohet në:

- Miratimin e Statutit;
- Miratimin e Rregullores së punës së Kuvendit;
- Përpilimin e politikës së Federatës;
- Miratimin e planprogramit të punës së Federatës;
- Vendos për bashkëpunim, anëtarësim dhe pjesëmarrje në gara që organizohen nga asociacione të ngjashme rajonale e më gjërë;
- Zgjedh dhe shkarkon kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët tjerë të Kryesisë;
- Zgjedh dhe shkarkon Komiteti Ekzekutiv të Federatës;
- Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës;
- Miraton sistemin e garave dhe vendos për ndryshimin eventual të tij;
- Miraton planin financiar të Federatës;
- Miraton planprogramin e punës së Këshillit Mbikqyrës;
- Kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin dhe aktet tjera të Federatës.

5.1.18. Kuvendi mund të formoj edhe komisione tjera apo edhe të autorizoj Komitetin Ekzekutiv që të formon komisione të ndryshme dhe të kryen punë tjera nga fusha e Kuvendit, të cilat më vonë do të votohen në Kuvend. Ato komisione mund të jenë të përkohshme apo të përhershme. Lidhur me kompetencat e tyre vendos Kuvendi dhe rrjedhimisht ato i përgjigjen Kuvendit.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

Komisione të tilla mund të janë:

- Komisioni i garave;
- Komisioni disiplinor;
- Komisioni për informim dhe marketing;
- Komisioni për mirënjohje; dhe
- Komisione tjera me rëndësi për aktivitetet e FSPK-ës.

5.2. KRYETARI

5.2.1. Kryetari i FSPK që është edhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv, zgjedhet nga Kuvendi me vota të fshehta me mandat 4 (katër) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

Kandidat për kryetar mund të propozohet secili anëtarë i Kuvendit kur paraprakisht siguron pëlqimin me shkrim të së paku 5 anëtarëve të Kuvendit.

5.2.2. Përgjegjësitë e Kryetarit:

- Përfaqëson FSPK-në,
- Fton dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv,
- Nënshkruan aktet e përgjithshme të cilat i bjen Kuvendi apo Komiteti Ekzekutiv,
- Përkujdest për zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv,
- Përkujdeset për krijim dhe ruajtje të marrëdhënjëve harmonike me të gjitha autoritetet, institucionet, partnerët dhe palët tjera të interesit,
- Emron dy (2) kandidat për Komitet Ekzekutiv,
- I propozon Komitetit Ekzekutiv për miratim emrat e dy (2) nënkryetarëve të KE,
- Kryen aktivitete të caktuara me këtë Statut dhe me aktet tjera të FSPK-së ose aktivitete që lidhen me funksionin e Kryetarit.

5.2.3. Kryetari për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.

Mandati i kryetarit mund të ndërpritet edhe para kalimit të 4 (katër) viteve në rastet kur:

- Kryetari e ndërron ose e humb shtetësinë,
- Kryetari tërhiqet nga pozita e tij ose ofron dorëheqje,
- Paraqiten kushte të tilla, për shkak të të cilave Kryetari nuk mundet me kry detyrën.

5.2.4. Kryetar mund të zgjedhet personi që plotëson kriteret në vijim:

- Të jetë shtetas i Kosovës,
- Preferohet të jetë veprimtar sportiv me rezultate në organizim dhe udhëheqje të sportit,
- Të ketë përgatitje superiore shkollore, dhe
- Të mos ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale, si dhe me parimet e Lëvizjes Olimpike.

NËNKRYETARËT

5.2.5. FSPK i ka edhe dy (2) nënkryetarë:

- Nënkryetari i parë (1), me autorizim të kryetarit, e zëvendëson kryetarin në përmbushje të punëve të përcaktuara me Statut sa herë që kryetari është i penguar të ushtroi detyrën e tij.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

- Nënkryetari i dytë (2), mirret me çështje të organizmit dhe mbarëvajtjes së garave.
- Nënkryetarët i zgjedh KE nga rradhët e veta, me propozim të kryetarit.
- Mandati i nënkryetarëve, sikur i kryetarit dhe i KE, është katër (4) vjeçar.
- Nënkryetarët duhet të marrin pjesë aktive në punët e KE dhe të organeve tjera të FSPK.

5.3. KOMITETI EKZEKUTIV

5.3.1. Komiteti Ekzekutiv i FPSK (në tekstin e mëtejshëm Komiteti Ekzekutiv) është organ ekzekutiv dhe udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit, dhe çdoherë duhet të veprojë në harmoni me qëllimet e Federatës;

Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv i thërret kryetari, e në mungesë të tij njëri nga nënkryetarët e Federatës, të autorizuar nga kryetari;

Mbledhjet e KE janë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nëse një gjë të tillë e kërkon shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kryesisë;

Komiteti Ekzekutiv, mbanë mbledhje sipas nevojës por, më së paku një herë në 3 muaj;

Komiteti Ekzekutiv, për punën e vet, i jep llogari Kuvendit të FSPK-ës;

5.3.2. Komiteti Ekzekutiv numëron 7 anëtarë. Përbëhet nga: Kryetari, dy (2) nënkryetarë dhe katër (4) anëtarë tjerë. Kuvendi zgjedhë katër (4) anëtarë, që me kryetarin e zgjedhur me procedurë të veçantë në Kuvend, bëhen pesë (5). Dy (2) anëtarët tjerë të KE, i emëron kryetari. KE, në mbledhjen e vet themeluese, me propozim të kryetarit, me vota të fshehta, zgjedhë dy (2) nënkryetarët. Anëtarët e propozuar për KE duhet të jenë delegat të Kuvendit ose anëtarë të KE të zgjedhur në Kuvendin paraprak.

5.3.3. Komiteti Ekzekutiv zgjedhet me mandat 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

5.3.4. Kryetari i Komiteti Ekzekutiv e përfaqëson KE-në dhe Federatën;

5.3.5. Kryetari i Komiteti Ekzekutiv përkatësisht Kryetari i Federatës, nënshkruan vendimet e Kuvendit dhe ato të KE-së.

5.3.6. Puna dhe vendim-marrja në KE, rregullohen me rregulloren mbi punën e KE;

5.3.7. Fusha e veprimtarisë së Komiteti Ekzekutiv përfshinë:

- Përpilon Statutin dhe i propozon Kuvendit për miratim;
- Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin për ato mbledhje;
- Ekzekuton vendimet e nxjerra nga Kuvendi;
- Përpilon planin e punës dhe planin financiar të Federatës;
- Cakton dhe kontrakton lartësinë e pagesës për gjyqtarë-referë të ndeshjeve;
- Nxjerrë vendime për vendin (fushën) e mbajtjes së garave (nëse nuk vendoset ndryshe);
- Cakton dhe kontrakton fushën për mbajtje të garave;
- Vendos për pranim të punëtorëve të administratës së Federatës;
- Vendos për blerjen e inventarit e materialit tjetër shpenzues për nevoja të FSPK-së; dhe
- Merrë vendime tjera që nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKR'S SPORTS FEDERATION

5.4. KËSHILLI MBIKQYRËS

5.4.1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet prej 3 anëtarëve. Këshillin Mbikqyrës e zgjedh Kuvendi me mandat 4 vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes;

Anëtari i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të jetë anëtar i organeve dhe trupave tjerë të FSPK.

5.4.2. Komiteti Ekzekutiv dhe të gjitha organet dhe trupat tjerë të Federatës, janë të obliguara që Këshillit Mbikëqyrës t'i mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre;

Këshilli Mbikëqyrës ka për detyrë me përcjellë punën e organeve të Kuvendit në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Federatës;

Këshilli mbikëqyrës, për punën e vetë, i raporton Kuvendit të FSPK-ës; dhe

Puna e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me Rregulloren mbi punën e Këshillit Mbikëqyrës.

6. KOMISIONET E KOMITETI EKZEKUTIV

6.1. E tërë fusha e veprimtarisë së komisioneve dhe puna e tyre, në mungesë të rregulloreve, definohet me vendime të Komiteti Ekzekutiv.

7. ZYRTARËT DHE NËPUNËSIT

7.1. Është e drejtë e KE që, sipas nevojës, të pranojë në punë persona për kryerjen e detyrave të Federatës, dhe për këtë e njofton Kuvendin në mbledhjen e parë të tij.

7.2. Kohëzgjatjen e punësimit të tyre e rregullon Komiteti Ekzekutiv.

7.3. Punësimi bëhet përmes marrëveshjes me shkrim, ku detalizohen të ardhurat dhe të mirat tjera që duhet t'i paguhet të punësuarit. Lartësia e pagesave duhet të jetë e arsyeshme dhe bëhet vetëm për punën e bërë.

8. GARAT

8.1. Garat zyrtare në Kosovë i organizon Komiteti Ekzekutiv i Federatës ose organi që e autorizon Komiteti Ekzekutiv.

8.2. Garat zhvillohen në bazë të rregullave të FSPK,

8.3. Organi përkatës që udhëheq me gara, duhet ti respektoj të gjitha vendimet e FSPK-së.

8.4. Të gjitha propozicionet e garave, fillimin, shtyerjen dhe të tjera, i miraton KE i FSPK-ës.

FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

KOSOVA WORKER'S SPORTS FEDERATION

9. SHPËRBËRJA E FEDERATËS

- 9.1. Federata mund të shpërbëhet me vendim të shumicës së anëtarëve të Federatës.
- 9.2. Në rast se vjen deri te shpërbërja, Kuvendi i Federatës do të vendos, pas përmbushjes së obligimeve, se kush do të përvetësoj pasurinë e mbetur.

10. NDRYSHIMET E STATUTIT

- 10.1. Statuti i tanishëm i Federatës mund të ndryshohet me vendim të 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të Federatës.

11. PERIUDHA E RAPORTIMIT DHE VITI FINANCIAR

- 11.1. Komiteti Ekzekutiv dhe zyrtarët e emëruar, do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Federatës ose kurdo që kërkohet nga Kuvendi.
- 11.2. Viti financiar i Federatës, përputhet me vitin kalendarik.

Statuti fillestar i Federatës është aprovuar në Prishtinë, më 12 shtator 2009, nga themeluesit e poshtshënuar.

1. PTK, Ismail Sadiku, _____,
2. TEB, Shpend Maxhera, _____,
3. Hekurudha e Kosovës, Sefedin Sefaj, _____,
4. Dogana e Kosovës, Naim Gerbeshi, _____,
5. Kompania IPKO, Besfort Jaha, _____,
6. KUJTESA, Nysret Sopi, _____.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti, janë miratuar në mbledhjen e Kuvendit të punës dhe atij zgjedhor më 27/01/2018.